

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

19 Nëntor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Kujdesi dhe Lidhja



Një grua e re në Kanada pa një vizion për një përmbytje dhe ndjeu nxitje të lutej specifikisht për një misionar Nazaretas . Kur misionari mësoi për lutjet e gruas së re, u prek thellë. Ai shpjegoi se, megjithëse nuk kishte përjetuar një përmbytje të vërtetë, përgjegjësitë e tij gjithnjë në rritje i ishin dukur si një përmbytje dërmuese. Ishte një bekim për të që të dinte se Perëndia e shihte dhe preku zemrën e saj në favor të tij.

Sa e ëmbël është mënyra se si Zoti e lidhi këtë grua të re dhe këtë misionar përmes lutjes. Por si e mori vesh ajo fillimisht për misionarin? Përmes **Kujdesit dhe Lidhjes**, një nga Pesë Fushat e Ndikimit të MNN-së.

Marrëdhëniet midis kishave lokale dhe misionarëve sjellin bekime për të dyja palët. Ne festojmë faktin që distriktet SHBA/Kanada po gjejnë mënyra krijuese për të ofruar Kujdes dhe Lidhje!



Në kampin e fëmijëve, distrikti i Filadelfias përdori një shabllon letre nga Kaleidoskopi për Fëmijë për ti inkurajuar fëmijët të shkruanin misionarëve të tyre të Lidhjeve, si dhe atyre të dërguar nga distrikti dhe atyre që kishin vizituar me deputim. Ndhmësit e rritur dërguan foto të letrave të çmuara të fëmijëve, - me gabime drejtshkrimore dhe vizatime nëpër cepa, nëpërmjet email-it dhe WhatsApp-it, me shënime që i ftonin misionarët të përgjigjeshin. Përgjigjet ndahen në buletin e MNN-së të distriktit. Fëmijët e Filadelfias morën gjithashtu pjesë në lutje në ecje bazuar në kërkesat për lutje dhe lavdërime nga broshura e Javës Globale të Lutjes për Fëmijë 2025. Fëmijët vendosën duart mbi harta dhe u lutën për misionarët në secilin rajon që kishin lidhje specifike me distriktin e tyre.



Kur një nga fëmijët e familjes Manswells, misionarë në Trinidad, u martua, MNN-ja e Kanadasë së Perëndimit organizoi një festë virtuale nusërie e cila u shndërrua në një festë të gëzueshme online. Ata dërguan kartolina dhuratash dhe dërguan shënime dhe foto nga të rritur dhe fëmijë me email.

WAPAC MNN ftoi misionarët e tyre të Links të udhëhiqnin Ditën e Misioneve të MNN-së. Me ndihmën e një të riu të talentuar në teknologji, ata postuan video të këtyre misionarëve në faqen e Facebook-ut të distriktit. Ata dërguan gjithashtu video përshëndetjeje nga Këshilli i MNN-së të Distriktit për misionarët të cilët me kënaqësi pranuan të bashkoheshin me konventën e MNN-së nëpërmjet video-telefonatës.

Për familjen Haun, misionarë në Bullgari, Kujdesi dhe Lidhja është një nga aspektet e tyre të preferuara të misionit. Ata komentuan: *"Ne jemi bekuar duke u lidhur me kaq shumë kisha dhe individë në distrikte me të cilat nuk do të kishim qenë kurrë të lidhur ndryshe. Kjo na kujton sa e vogël është bota Nazaretase dhe sa të ndërlidhur jemi të gjithë!"*

Rajoni SHBA/Kanada nuk është i vetëm. Kishat në çdo rajon marrin pjesë në Kujdes dhe Lidhje. Misionarja Heidi Bowes është e lidhur me Distriktin e Barbadosit. Ajo gëzohet kur merr mesazhe të herëpashershme në WhatsApp që e pyesin si është dhe si mund të luten për të. Ajo ndan: *"Çfarë bekimi! Kishat në Barbados po luten për një misionare Amerikane që jeton në Zvicër, e cila punon me njerëz të vendosur midis Irlandës deri në Sri Lanka. Ashtu si Kisha e Nazaretasit është një kishë globale, Links ilustron partneritetin global që kemi në misionin e Zotit së bashku, ndërsa ndjekim Frymën e Tij që nuk njeh kufij."*

Rajoni SHBA-së/Kanadasë

Shtetet e Bashkuara



Puna e Kishës së Nazaretasit filloi zyrtarisht në Shtetet e Bashkuara në vitin 1887, megjithëse organizimi formal i denominacionit ndodhi në vitin 1908 me bashkimin e disa grupeve të shenjtërisë me mendime të njëjta. Sot, Nazaretasit mbledhen në kisha lokale në çdo shtet brenda SHBA-së. Ka një theksim të ripërtërirë në ungjillizim, dishepullizim dhe mbjellje kishash, duke angazhuar të gjitha moshat në misionin e Zotit. Të rinjtë po zënë vendin e tyre si udhëheqës dhe punonjës misionarë, duke kaluar kufijtë përtej zonave të tyre të rehatisë, për të ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit. Mesazhi i Shenjtërisë Biblike është më i rëndësishëm se kurrë, dhe ai përqafton dhe sfidon të gjitha moshat.



558,147 Anëtarë



4,216 Kisha të Organizuara;
685 Kisha të paorganizuara
ende



2,129 Shërbëtorë të Liçensuar
dhe 11,223 Shëebëtorë të
Shuguruar në 73 Distrikte

Lavdërimi

- Falënderoni Zotin për mënyrat frymëzuese krijuese për të treguar dashuri dhe kujdes për misionarët Nazaretas, dhe veçanërisht për ata që ndihmojnë qëllimisht fëmijët dhe të rinjtë të lidhen me misionarët.
- Falënderoni Zotin për gëzimin e të qenit pjesë e një kishë mjaft të madhe për të arritur të gjithë botën, por mjaftueshëm të lidhur për t'u ndjerë si familje.



Kërkesa Lutjeje:

- Lutuni që më shumë distrikte dhe kisha lokale të zbulojnë gëzimin e angazhimit në Kujdes dhe Lidhje me misionarët Nazaretas.
- Lutuni që misionarët tanë të inkurajohen nga kisha dërguese, veçanërisht gjatë sezonit të ardhshëm të Krishtlindjeve.



A mund të Shërbeni?

A po ju thërret Perëndia të bashkoheni në misionin e Tij, pavarësisht moshës suaj, për hir të të tjerëve? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

NMI Central është i disponueshëm në një arkiv PDF të kuruar. Për të lexuar botimet e mëparshme, [klikoni këtu](#).



KISHA  NAZARENIT
MISSIONET NDËRKOMBËTARE
NAZARETASE